



Nr. Prot.: 04/1353  
Datë: 08/11/2018

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", duke u mbështetur në vendimin e Senatit nr. 04/1353 të datës 07.11.2018, shpall:

K O N K U R S  
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT  
TË GJAKOVËS "FEHMI AGANI" PËR VITIN AKADEMIK 2018/2019

**I. Kushtet e përgjithshme**

Për fitimin e bursës së Universitetit të Gjakovës, studentët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë studentë të rregullt të fakulteteve të Universitetit të Gjakovës;
2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë;
3. T'i kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit të vitit akademik 2017/2018;
4. Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
5. Të kenë notën mesatare së paku 9,00 (nëntë pikë zero);
6. Të mos jenë përfitues të ndonjë burse tjetër.

**II. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim**

1. Kërkesa /aplikacioni i cili mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Universitetit,
  2. Vërtetimi për statusin e studentit i vitit akademik 2018/2019 (lëshohet nga Fakulteti pa pagesë dhe shërben vetëm për bursë),
  3. Certifikata e vërtetuar e notave nga Fakulteti me notë mesatare të cekur (lëshohet nga Fakulteti pa pagesë dhe shërben vetëm për bursë),
  4. Vërtetimi se i ka dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak në afatin e shtatorit,
  5. Vërtetimi mbi xhirollogarinë bankare të lëshuar nga Banka,
  6. Kopja e letërnjoftimit.
- Dokumentet e kompletuara dorëzohen fizikisht në zyrën e shërbimit të studentëve në fakultetin përkatës.
  - Afati i paraqitjes zgjat prej datës 09.11.2018 deri më 19.11.2018 në ora 15.00.

Bursat universitare për vitin akademik 2018/2019 do t'u ndahen të gjithë studentëve të UGJFA-së, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë konkurs, ndërsa lartësia e bursës do të përcaktohet varësisht nga buxheti për bursa i Universitetit të Gjakovës dhe nga numri studentëve që i plotësojnë kushtet për fitimin e bursës Universitare.

**III. Afati i Ankesave**

Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e përfituesve të bursës kanë të drejtë ankese në afat prej 48 orësh pas ditës së publikimit të listave.

Ankesa duhet të dorëzohet në Rektorat.

Vendimi do të publikohet në tabelën e shpalljeve të fakulteteve dhe në ueb-faqen e Universitetit: [www.uni-gjk.org](http://www.uni-gjk.org)

